# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-433531**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Sakrifica jote nuk do të harrohet”, kryepolici Hita viziton efektivin e plagosur në Maliq: Do jem në krah të çdo punonjësi |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/sakrifica-jote-nuk-do-te-harrohet-kryepolici-hita-viziton-efektivin-e-pl-i585011` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 15:56:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 16:30:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4216eef6ad1f913dd827b7a3fe1ec73c74968f7170c04718fba0020c4231db34` |
| TEKSTI | `0066181a1586b9425b6f812e00e90d3cb01f885374e818b0e00808b4e24a091f` |
| PAMJA | `c34013701d89bc59e56fc17b2ab1e8f0b8c5f00567e7a4eff3d3ffd29d88818d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c0a018b0ceebdbe3f37d9c8b1262eb0d996e7cb8eec40069c05c0d6e1dc1cef2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c0a018b0ceebdbe3f37d9c8b1262eb0d996e7cb8eec40069c05c0d6e1dc1cef2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# “Sakrifica jote nuk do të harrohet”, kryepolici Hita viziton efektivin e plagosur në Maliq: Do jem në krah të çdo punonjësi

9 Shtator 2026, 18:30Kronika TEMA

“Sakrifica jote nuk do të harrohet”, kryepolici Hita viziton

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Skender Hita, vizitoi në banesë punonjësin e Policisë Edison Adri, i cili u plagos gjatë operacionit në malin e Bodenit, në Maliq, për kapjen e një personi të kërkuar, ku humbi jetën kolegu i tij, Dëshmori i Atdheut, Enea Mekolli.

Pas përfundimit të trajtimit mjekësor në Itali, Edison Adri është kthyer në banesë, ku vijon periudhën e rikuperimit. Drejtori i Përgjithshëm u takua me të dhe familjarët e tij, duke i përcjellë mbështetjen e Policisë së Shtetit dhe mirënjohjen për sakrificën e tij në përmbushje të detyrës.

Gjatë vizitës, drejtues Madhor Skender Hita u shpreh:

“Edison, së pari, gëzohem shumë që je kthyer në shtëpi, pas një kurimi të vështirë në Itali. Kam ardhur sot këtu jo vetëm si Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, por mbi të gjitha si koleg dhe si një prej njerëzve të familjes së madhe të Policisë, dhe për fjalën e dhënë se do të jem krah teje, ashtu siç do të jem krah çdo punonjësi policie që punon dhe sakrifikon për ligjin dhe qytetarët.

Sakrifica e Eneas, tashmë Dëshmor i Atdheut dhe sakrifica jote nuk do të harrohen kurrë. Jam shumë i kënaqur që sot po të shoh këtu, në shtëpinë tënde, duke u rikuperuar. E di që vuajte shumë dhe se rruga e rikuperimit kërkon kohë dhe forcë, por dua të dish se nuk je vetëm. Policia e Shtetit, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria shqiptare janë pranë teje dhe vlerësojnë e mbështesin çdo sakrificë që i shërben sundimit të ligjit.

Ti e bëre detyrën tënde, tani është detyra jonë të vijojmë të jemi pranë teje, në çdo kohë. Uroj që dita-ditës të bëhesh më mirë, të marrësh veten plotësisht dhe të rikthehesh sa më shpejt në detyrë, aty ku të presin kolegët dhe detyra në shërbim të qytetarëve ”

Punonjësi i Policisë Edison Adri falënderoi Drejtorin e Përgjithshëm për vizitën dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe të gjithë ata që kontribuuan për trajtimin dhe kurimin e tij jashtë shtetit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

APSK: Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara u rritën me 30%, afro 2 milionë euro në 8-mujor

17:40 Kronika

Kreu i AMP pret të dërguarin e Trump, Zampolli! Në fokus lufta ndaj fentanilit dhe kundër trafikut të drogës

15:23 Kronika

Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-vjeçari që u gjet në bagazhin e një makine me duar të lidhura!

14:50 Kronika / 5 komente

Burgjet nën "përgjim", 148 punonjës dhe 196 të izoluar të proceduar, kontrolle edhe ndaj familjarëve!

12:15 Kronika / 1 koment

Një i vdekur dhe tre të plagosur pasi ranë në kontakt me rrymën, Policia ndalon zyrtarët e Bashkisë Tropojë

11:45 Kronika

EMRI/ Shkaktoi aksidentin me vdekje në Angli, ky është shqiptari i shpallur në kërkim!

11:15 Kronika / 2 komente

Mbyllet takimi në Korçë, zbulohen 4 porositë që kryepolici Hita u la vartësve: Droga, siguria në shkolla, krimi kufitar d

11:05 Kronika / 1 koment

43 vatra zjarri në 24 orë në vend, 13 ende aktive - Mbrojtja: Vijon angazhimi i qindra forcave dhe mjeteve

10:35 Kronika / 1 koment

Korçë/ Zbardhen dy vjedhje, arrestohet 18-vjeçari dhe shpallet në kërkim bashkëpunëtori

10:15 Kronika

VIDEO/ Shpërthimi i pikës së karburantit, kreu i Shërbimit Zjarrfikës jep detaje: Flakët nisën nga rrjedhja e gazit, po hetohet nëse ka patur defekt teknik

10:05 Kronika / 3 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...**

14:15 Politika / 54 komente

**FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...**

17:35 Politika / 130 komente

**Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...**

14:50 Politika / 10 komente

**Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...**

22:50 Kronika / 6 komente

**Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...**

19:40 Politika / 125 komente

## Blog Tema

**Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?**

17:30 Blog

**Republika popullore e protestës**

15:20 Blog / 41 komente

**Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet…**

13:00 Blog / 14 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.